

## **REFORMA E NDARJES ADMINISTRATIVE<sup>i</sup>**

*nga Niko Nako*

*Jo bashkime mekanike dhe aritmetike. Reforma eshte e vonuar, por nuk duhet shpejtuar. Është e domosdoshme, por nevojitet studim.*

Propozohet që reforma territoriale të bëhet me faza dhe e shkallëzuar, të nisë si një projekt pilot, të fillojë bashkimi vullnetar, të hapet një diskutim me popullatën e këtyre zonave, pasi nga 374, NJQV (66 bashki dhe 308 komuna) që kemi aktualisht, do të shkrihen rreth 224 ose rreth 60 % e tyre dhe do të mbeten rreth 150 Njësi të Qeverisjes vendore. Të përkthyer në shifra kjo reformë do të ketë efekte në mbi 500 mijë banorë dhe mbi 100 mijë familje.

Mbështetim këtë reformë por vetëm pas kryerjes të një studimi me pjesëmarrjen jo vetëm të ministrisë së Brendshme, Prefekturave, Ministrisë për çështjet vendore, të marrin pjesë edhe aktorë të tjerë, si; Shoqata e Bashkive, Shoqëria civile, këshillat e Qarqeve, Universiteti Bujqësor i Tiranës, ministrinë e Bujqësisë dhe Mjedisit me gjithë strukturat në rrethe. (Drejtori Bujqësie, Shërbimi Pyjor) etj.

### **Pak histori:**

Ndarja e parë territoriale administrative-tokësore pas ndryshimeve demokratike është kryer në vitin 1992 sipas VKM nr. 269, datë 25.06.1992 “Për ndarjen administrativo- tokësore të Republikës së Shqipërisë.” Pavarësisht përvojës 10 vjeçare në demokraci, kësaj ndarje nuk i është bërë ndonjë studim i veçantë.

Në vitin 2000, u miratua ndarja administrative, me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” ku nuk u bë asnjë ndryshim nga ndarja e mëparshme. Kjo ndarje është si rrjedhojë e zhvillimeve historike të shtetit shqiptar. Në këtë mënyrë u miratua ndarja me 65 bashki, 308 komuna dhe 12 qarqe. Kjo ndarje nuk është bazuar në ndonjë studim të veçantë të faktorëve mbështetës të cilët do të ndikonin në përmirësimin e gjendjes.

*Si paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat e pushtetit vendor në vitin buxhetor 2012 ?*

Për të krijuar nja panoramë mbi shpenzimet e pushtetit vendor dhe burimet e financimit sa nga granditë e qeverisë dhe sa nga të ardhurat për periudhën 10 vjeçare 2002-2012, kemi tabelën e mëposhtme:

Nr	VITET	Shpenzimet për pushtetin vendor	Nga këto; Burimet e financimit janë financuar nga:			
			Grandi nga buxheti i shtetit Për pushtetin vendor		Të ardhurat nga taksat dhe tarifat Vendore	
			Në milion lekë	Në milion lekë	Në %	Në milion lekë
1	2002	12,288	9,073	73,8	3,216	26,2
2	2003	14,244	6,627	46,5	7,617	36,5
3	2004	15,904	6,617	41,6	9,287	54
4	2005	19,999	7,516	37,5	12,483	62,5
5	2006	22,713	10,100	44,5	11,216	55,5
6	2007	21,340	11,974	56,1	9,366	43,9
7	2008	27,079	15,772	58,2	11,307	41,8
8	2009	33,582	21,433	63,8	12,149	36,2
9	2010	30,764	18,866	61,3	11,898	37
10	2011	29,314	14,014	47,8	15,300	52,5
11	2012	29,503	13,876	47	14,624	53
<b>Gjithsej</b>		<b>256,730</b>	<b>135,868</b>	<b>53</b>	<b>118,463</b>	<b>47</b>

Shënim: Burim i të dhënave të mësipërme janë marrë nga seminari i zhvilluar në Durrës, nga Ministria e Brendshme, në muajin Maj 2013.

Referuar pasqyrës së mësipërme rezulton se granti i Qeverisë për periudhën 2002-2005 ka ardhur duke u ulur nga 74% në 38%, ose në masën 36 %.

Për periudhën 2006-2010 granti ka ardhur duke u rritur nga 45% në 62% ose në masën 17%. Dhënia e grantit më ta lartë prej 64% shënohet për vitin 2009.

Kurse uljen më të madhe granti e ka pasur në 2 vitet e krizës 2011-2012 në 47%.

Të gjithë janë dakord të kryhet një reformë dhe ndarje e re administrative si të majtët ashtu dhe të djathtë. Jepen si argumente që këto komuna e rendojnë buxhetin e shtetit dhe nuk rigjenerojnë të ardhura, deri këtu të gjithëve u japim të drejtë. Edhe ndarja mund të bëhet brenda një viti, duke përgatitur opinionin, bazën ligjore dhe ja jemi në qershor 2015 kur do hyjmë në zgjedhjet lokale. Nga 374, NJQV (66 bashki dhe 308 komuna) që kemi aktualisht, do të shkrihen rreth 224 ose rreth 60 % e tyre dhe do të mbeten rreth 150 Njësi të Qeverisjes vendore.

Nëpërmjet shtypit bëhet e ditur se do të ketë 36 rrethe sikur kanë qenë, ( në fakt edhe sot 36 rrethe kemi) dhe do të ndahen në 3 Fasha :

-1 qendër e madhe bashkie urbane, (Tirana)

-Bashki rurale me 30 mije banorë

-Njësi rurale me 20 mijë banorë.

-Njësi të vogla rurale me 10 mijë banorë.

Deri tashti asnjë institucion përgjegjës nuk ka marrë përsipër dhe të sqarojë opinion publik, komunat dhe bashkitë që do bashkohen, se nga 224 NJQV, buxhetit të shtetit do t'i kursehen kaq apo aq miliona lekë.

Shtrojmë pyetjen pse të ketë vetëm 1 bashki rurale? mund të ketë disa si; Durrësi, Fieri, Elbasani, Vlora, pasi edhe këto bashki kanë një popullsi më të madhe se kishte Tirana, kur është miratuar ligji.

*Te ardhurat lokale*

Edhe sot këto bashki vuajnë mënyrën e organizimit dhe mungesën e strukturave për mbledhjen e të ardhurave, pasi njësitë administrative (rajonet) nuk kanë asnjë kompetencë, ndërkohë që kanë administratë, ato vetëm arkëtojnë të ardhurat nuk kanë struktura për mbledhjen me forcë të taksave.

Ndërsa bashkia Tiranë është e organizuar sipas një ligji të veçantë. Por edhe në Tiranë nuk mbledhet taksat e popullatës për pasurinë. Jemi për një reformë dhe riorganizim në funksion të krijimit të struktura për mbledhjen e taksave nga qytetarët, si taksën e banesës, pastrimit që ka mi 20 vjet e cila nuk mbledhet. Duke u marrë me reforma të mëdha harojmë krijimin e strukturave dhe gjerave të vogla. Sa qytetarë nuk paguajnë sot taksa? përgjigja është mbi 80% e kthyer në lekë, janë me miliarda. Vetëm në Tiranë mbledhen 10% të taksave të pasurisë, etj, po në rrethet nuk mbledhen më shumë se 30%, madje ka edhe qytete tjera të cilët nuk mbledhin asnjë lek.

Në bashkinë Tiranë 11 njësitë bashkiake nuk kanë asnjë kompetencë, pasi vetëm arkëtojnë taksat që derdhin qytetarët në mënyrë vullnetare dhe i derdhin në bashkinë e madhe, pasi edhe këtu mungojnë strukturat për mbledhjen me forcë të taksave për popullatën duke ja lënë atë dëshirës të qytetarëve. Le të më thotë vetëm një rast dhe cila njësi bashkiake ka dërguar njoftime qytetareve (popullatës), për pagesën e taksave zyrtarisht me poste dhe jo më të kërkohen në rrugë gjyqësore ?. Madje edhe pse taksat janë amnistuar (falur) në vitin 2010 ende nuk paguhen dhe janë krijuar debitorë të tjerë.

Sot kemi 12 komuna nën 1000 banorë dhe 170 komuna nën 5000 banorë, ose 60% dhe 126 komuna mbi 5000 banorë. Mendohet se për kryerjen e reformës administrative territoriale do shërbejnë tre kritere kryesore në këtë

ndarje, atë gjeografik, social dhe kulturor në një të vetëm, kriterin e numrit të popullsisë dhe kriterin ekonomik. Në pamje të parë kjo duket një gjë e thjeshtë, por po ti analizosh shumë faktorë dalin mjaft probleme. Nuk duhet lënë pas dore edhe faktorët e tjerë që ndikojnë në kryerjen e me sukses të kësaj reforme si, *sipërfaqja e tokave, sipërfaqja e pyjeve, kullotave që ka komuna në pronësi, ujerat dhe kanalet që përdoren për vaditje, pa përmendur këtu numrin e blegtorisë dhe faktorë të tjerë që mund të dalin gjatë procesit të bashkimit. Nuk do të ishte pa interes të dihet struktura e moshës që banon në këto zona, sa prej tyre janë të rinj, sa në moshën për punë dhe sa shkojnë në fshat vetëm për pushime.*

Mos harrojmë se do shkurtohen vetëm punonjësit e administratës, madje as gjysma e tyre, pasi komunat duke u bashkuar ulet numri i komunave, por punonjësit e administratës do të kalojnë tek tjetra, punonjësit e shërbimit, si ujësjellës, pastrimit, gjelbërimit, taksave, etj, do të mbeten, në shërbim të komunitetit, **në mos do të shtohen.** Pra përveç mentalitetit duhet të përmbysset i gjithë sistemi i pagave aktual i cili është krijuar mbi numrin e banorëve që ka aktualisht NJQV. Duke u shtuar puna dhe numri i banorëve natyrisht duhet të këtë përmirësime në pagë. Suprimohen Gjendjet civile që ka secila NJQV, të cilat janë të shumta.

Sipas kriterëve të numrit të popullsisë dhe realizimit të të ardhurave, nuk ka nevojë për studime dhe shumë mend, por do të shkrihen komunat në zonat verilindore dhe më të prekurit do jenë; **Kukësi, Tropoja, Dibra, Puka, Mirdita, Malësi e Madhe,** dhe më pak, komuna të zonës qendrore dhe më pak jugore.

Mos ne kështu ndikojmë që fshati dhe pronat bujqësore dhe pyjore të cilat mendohet se i kanë kaluar në pronësi komunave, do të braktisen? Fshatari,

duke pasur larg shërbimin do të largohet nga fshati për një jetë më të mirë, **duke ulur edhe prodhimin e përgjithshëm bruto**. Në se rreth 100,000 persona nga fshati, do të largohen për në zonat me shërbim, a do ketë kapacitete zonat urbane që këta persona të strehohen dhe punësohen?

*Reforma: Kush mund të ndihmojë?*

Për ndarjen administrative dhe territoriale nevojitet një studim i mirëfilltë dhe komunë për komunë, duke nxjerrë rezultate konkrete përfitimet nga kjo reformë, ka mjaft specialistë të aftë e me përvojë në komuna dhe bashki që e njohin shumë mirë aktivitetin dhe funksionimin e pushtetit vendor.

Një ndihmë mund të japë edhe Universiteti Bujqësor i Tiranës i cili numëron mbi 6-7 mijë specialistë në studim dhe me dhjetëra kandidatë shkencash, profesorate, bujqësore, etj. Po ministria e bujqësisë me 30 Drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në rrethe dhe ministria e Mjedisit me Drejtoritë rajonale të shërbimit pyjor në rrethe, kanë Departamente dhe specialistë të cilët e njohin shumë mirë situatën dhe secili mund të kontribuojë sadopak për këtë reformë.

Kjo reformë të mos i lihet vetëm Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, apo Ministrisë së Brendshme. Jam dakord që komisionet e ndarjes territoriale të drejtohen nga Prefekti, por pse është lënë jashtë Këshilli i Qarkut, i cili ka më shumë punonjës, kryetarët e komunave janë antarë të këshillit Qarkut dhe më kryesorja ka më shumë specialistë dhe struktura që ndjekin dhe njohin problemet në fshat si. Zyrat e tokave, kadastrat, infrastrukturën, urbanistikën, inspektorate ndërtimore, etj.

Jemi 20 vjet më vonë dhe teknologjia e informacionit dhe përpunimit të të dhënave ka përparuar. Ministria e Brendshme i ka të dhënat për fondet dhe numrin e punonjësve për çdo komunë, pra së bashku me komunat dhe bashkitë të cilat do të bashkohen të hartojnë pasqyra dhe pyetësorë. Ne i

kemi provuar reformat e nxituara. Jo bashkime mekanike dhe aritmetike nga zyra.

**Reforma territoriale në se nuk hipotekohet nga asnjë forcë politike dhe mobilizohen të gjithë, është e mundshme të kryhet brenda mandatit zgjedhor Maj- 2015.**

*Reforma territoriale kam mendimin që të kryhet me faza dhe e shkallëzuar, të nisë si një projekt pilot, të fillojë bashkimi vullnetar, të hapet një diskutim me popullatën e këtyre zonave, të organizohen tryeza të rrumbullakëta, emisione televizive, pasi në rreth 170 komuna të cilat kanë nën 5.000 banorë jetojnë rreth 450 - 500 mijë banorë, ose rreth 80 mijë familje.*

**Në ndryshimet kushtetuese mendoj që të përfshihet dhe ristrukturimi i qarqeve, ku “vegjetojnë” jo me pak se 50 punonjës për Qark, e cila kërkon një studim tjetër nga ky i komunave.**

Ka mendime që bizneset e pushtetit vendor të përqendrohen në një administratë tatimore, e mbështes këtë përqendrim, pasi edhe administrata që ndjek taksat vendore një pjesë sidomos në komuna nuk e njohin legjislacionin tatimor, po kështu do të zgjidhet dhe konflikti që ekziston mbi të drejtën e kontrollit të kasave fiskale dhe përdorimi i tyre.

Por, duhet të përcaktohet me ligj se cila taksë do të mbeten pushtetit vendor, ka disa lloj taksash që detyrimisht duhet të mbeten në pushtetin vendor, si taksa e tokës, tarifë e ndërtesës, tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, etj. Po kush është i sigurtë se kjo administratë do të mbledhë të ardhurat, ne i kishim në Drejtoritë Rajonale dhe ja u kaluam komunave dhe bashkive. Në se përqendrohen kush e kreu studimin se sa punonjës do shtohen apo

pakësohen dhe ku është efektiviteti, sa do rriten të ardhurat. Mos edhe kjo reformë duhet të bëhet me komuna apo bashki Pilot dhe në mënyrë të shkallëzuar?

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 30 Dhjetor 2013